

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

**Praktika profesionale
zgjidhjet**

P12

Data 16/10/2022

Detyra 1

Grupi Atlantik sh. p. k. (kompani publike) publikon një revistë të përmuajshme 'Deti i kaltër'. Përafërsisht 70% e të hyrave nga shitja të revistës përftohen nga reklammat e dhëna në të, pjesa tjetër prej të hyrave nga abonimi dhe shitjet e revistës nëpër librari.

Reklammat individuale, të cilat mund të zënë një të katërtën, gjysmën dhe të tërë faqen kushtojnë €750, €1,250 dhe €2,000, përkatësisht. Zbritjet prej 10% deri në 25% i jepen reklamave që përsëriten dhe klientëve të cilët vendosin shumë reklama.

Menaxhmenti i Grupit Atlantik ka identifikuar rreziqet e mëposhtme që kanë të bëjnë me të hyrat e tij nga shitja e reklamave:

(i) Humbja e të hyrave si rrjedhojë e faktit se kompania nuk arrin të investojë në zhvillime të tilla teknologjike të cilat bëjnë që reklammat të paraqiten në të njëjtin nivel si ai i konkurrentëve (publikime të tilla si 'Eksploruesi');

(ii) Për shkak se departamenti i financave ka vendosur kufij të papërshtatshëm, biznesi pranohet vetën nga një pjesë e vogël e klientëve që japin reklama, të cilët konkurrentët nuk i bëjnë shitje me kredi;

(iii) Reklammat e botuara ka mundësi të mos faturohen si rrjedhojë e shkëputjeve në komunikimet midis departamenteve që merren me botimin dhe departamentit të faturimit;

(iv) Reklammat individuale nuk faturohen për pagesat e dakorduara – zakonisht si rrjedhojë e gabimeve me ata që japin reklammat. Veçanërisht, departamenti që merret me botimet nuk e lajmëron departamentin e faturimit për sa i takon marrëveshjeve reciproke për çmime, ndërsa klientët që japin reklama i ofrojnë Grupit Atlantik forma të tjera të reklamimit (të tilla si shiritat me banderolat me reklama në internet).

(v) Reklamuesit individualë nuk pranojnë të paguajnë nëse cilësia e reklamës së tyre nuk është e kënaqshme;

(vi) Paratë e gatshme të arkëtuara në tryezën e informacionit, të cilat janë domethënëse si shuma monetare, mund të mos i kalohen arkëtarëve, ose mund të përvetësohen e të vidhen;

(vii) Rreziku i gabimeve që vijnë si rrjedhojë e qasjes së papërshtatshme ndaj sistemeve të botimit dhe të faturimit;

(viii) Rreziku që sistemet e botimit dhe të faturimit të mos jenë në dispozicion për përdorim;

(ix) Transferi i kompjuterizuar i informacioneve kontabël nga sistemi i faturimit deri në librat e llogarive ose dhe librin kryesor mund të mos jetë i plotë ose të jetë i gabuar;

(x) Rreziku që Grupi Atlantik të paditet për reklama të cilat nuk përmbushin Kodin e Autoritetit të Standardeve për Reklama.

Rreziqet duhet të kontrollohen, si të pa – pranueshme, nëse ata përmbushin **çdonjërën** nga kriteret e mëposhtme:

(1) Efekti i rrezikut mund të shprehet me terma sasiore dhe është më pak se sa € 5,000;

(2) Rreziku reduktohet me anë të një strategjie efektive të rrezikut p. sh. me anë të sigurimit;

(3) Rreziku ka shumë gjasa të jetë i ulët ose efektet e tij të mos jenë domethënëse.

Ato rreziqe që mund të mos eliminohen dhe të cilat quhen 'rreziqet që mund të dalin në pah', do të duhet të mbahen parasysh edhe më tej dhe të menaxhohen në mënyrë aktive.

Kërkohet

(a) Për secilin prej rreziqeve të identifikuara më sipër nga menaxhmenti, vlerësoni me një arsye, faktin nëse duhet të konsiderohen si 'rreziqe që mund të dalin në pah'. **(17 pikë)**

(b) Përshkruani kontrollet e duhura të brendshme me anë të të cilave mund të menaxhohen të paktën KATËR nga rreziqet e identifikuara që mund të dalin në pah sipas pikës (a). **(8 pikë)**

(Totali = 25 pikë)

Zgjidhja

(a) Rreziqet e aplikueshme

(i) Paaftësia për të investuar në zhvillimet e reja

Rrezik i vlefshëm (i aplikueshëm)

Shumica e të ardhurave të Grupit Atlantik vijnë nga të hyrat nga reklamat dhe në këtë mënyrë është shumë kritike që ata të vazhdojnë të jenë të parët që mbajnë flamurin e zhvillimeve në fushën e reklamave, dhe sidomos për shkak se kështu bëjnë edhe konkurrentët e tyre. Në rast se ata që porosisin reklama do të heqin dorë nga reklamat në Grupin Atlantik, për t'ia dhënë këtë punë firmave konkurrencte që përdorin teknika më të avancuara të reklamimit të tilla si 'Eksploruesi', do të dalë në pah një ndikim negativ domethënës mbi financat.

(ii) Kufij të papërshtatshëm të kreditimit

Rrezik jo i aplikueshëm

Meqenëse kufijtë e kreditimit janë vendosur tashmë, (megjithëse nuk janë të përshtatshëm), dhe shumica e klientëve ka shumë gjasa që të jenë të besueshëm për t'iu ofruar shitje me kredi, ndikimi i një numri të vogël të firmave që porosisin reklama dhe që nuk i paguajnë borxhet nuk ka gjasa të jetë domethënës.

(iii) Transferimi jo i plotë i të dhënave (departamenti i botimit dhe departamenti i faturimit)

Rrezik i aplikueshëm

Është thelbësore për rrjedhjet e parave të gatshme dhe për veprimtaritë e biznesit që reklamat e botuara të faturohen. Nëse harrohet të faturohen vetëm dy reklama me faqe të plotë dhe një reklamë gjysmë faqëshe, mund të gjykohe se efekti i këtij rreziku është më i madhe se sa € 5,000. Në rast se sistemi nuk arrin të transferojë të dhënat, nuk ka arsye të besohet se ky problem kufizohet vetëm me një numër të vogël të reklamave.

(iv) Normat e tarifave të faturuara

Rrezik i aplikueshëm

Siç e pamë edhe më sipër, duke pasur parasysh çmimet e reklamave, një problem me një numër të vogël të reklamave të botuara mund të ketë një ndikim domethënës (> € 5,000). Në këtë mënyrë, për shembull, në rast se dy reklamimeve një faqëshe dhe tre reklamave gjysmë faqëshe do t'i ishte ofruar një zbritje prej 50% dhe i njëjti numër i reklamimeve do të ishte dhënë 'pa pagesë', diçka e tillë do të kishte pasur një ndikim domethënës financiar.

(v) Gabimet individuale

Rrezik jo i aplikueshëm

Grupi Atlantik me mundësi të madhe ushtron kontrolle të arsyeshme mbi produksionin e reklamave duke bërë të sigurt se gabimet gjatë produksionit, të tilla si gabimet ortografike, problemet me ngjyrat dhe probleme të ngjashme ka shumë gjasa të izolohen veçmas, në mënyrë që asnjë reklamë individuale e botuar të mos ketë ndonjë ndikim domethënës financiar mbi Grupin Atlantik.

(vi) **Përvetësimet e parave të gatshme**

Rrezik i aplikueshëm

Paratë e gatshme të arkëtuara nga recepsioni kapin vlera domethënëse dhe me sa duket nuk ka kontrole të cilat të bëjnë të sigurt se paratë e gatshme janë të sigurta dhe se iu kalohen arkëtarëve në kohën kur arkëtohen. Ky është një rrezik i madh për Grupin Atlantik për shkak se ata thjeshtë mund të humbasin një shumë të madhe të të ardhurave në këtë mënyrë. Përsëri, mjafton përvetësimi i vetëm një pagese për tre reklama me faqe të plotë që përsëri të dalë në pah një efekt domethënës.

(vii) **Gabimet për shkak të qasjeve të paautorizuara**

Rrezik jo i aplikueshëm

Ka shumë gjasa që Grupi Atlantik të ketë në funksion kontrollet themelore mbi sistemet kompjuterike, gjë që e bën këtë rrezik diçka që nuk ka shumë mundësi të ndodhë.

(viii) **Qenia në dispozicion e sistemeve**

Rrezik i aplikueshëm

Ky lloj i rrezikut është i vlefshëm për shkak se në rast se Grupi Atlantik nuk ka plane rezervë kontingjente kundrejt dështimeve ose prishjes së sistemeve, dhe shumica e kompanive me sisteme të kompjuterizuara nuk e kanë diçka të tillë, atëherë rreziku financiar dhe operacional i vonësës së faturimit dhe përpunimit të reklamave të marra do të jetë domethënës për sa i takon përmbushjes së kërkesave të klientëve dhe vonësave në pagesa.

(ix) **Transferimet e pa - plota të informacioneve tek librat kryesorë**

Rrezik jo i aplikueshëm

Diçka e tillë mund të jetë domethënëse për sa i takon rezultateve të raportuara të kompanisë por ajo nuk ka ndonjë ndikim mbi fuqinë e sak operacionale ose financiare.

(x) **Rreziku i hedhjes në gjyq për reklama të papërshtatshme**

Rrezik i aplikueshëm

Meqenëse Grupi Atlantik realizon një pjesë të madhe të të hyrave nga reklamat prej publikimit të tij, ky rrezik është domethënës. Megjithëse Grupi Atlantik ka shumë gjasa të ketë një sigurim për sa i takon ndikimit financiar të çështjeve të tilla gjyqësore, kostot për sa i takon humbjes së reputacionit dhe në këtë mënyrë të klientëve, me mundësi të madhe do të jenë domethënëse.

(b) **Kontrollet**

(Kujdes. Pyetja kërkon nga ju vetëm të tregoni se cilat janë kontrollet për katër nga rreziqet e aplikueshme. Të gjithë kontrollet (gjashtë) janë mbuluar në këtë përgjigje vetëm për qëllim të ilustrimit).

(i) **Paaftësia për të investuar në zhvillimet e reja**

- Rishikime të rregullta të zhvillimeve të produkteve të konkurrentëve (për shembull, rishikimi i secilit botim, ose rishikimi i secilës reklamë)
- Rishikim i rregullt i zhvillimeve në dispozicion në mënyrë që të jenë të gatshëm për të vepruar në rast se është e nevojshme

- Rishikim i rregullt i kostove aktuale të investimeve kundrejt buxhetit, për të parë në qoftë se mund të përdoret ndonjë tepricë buxhetore
- (iii) **Transferimi jo i plotë i të dhënave (departamenti i botimit dhe departamenti i faturimit)**
- Rakordimi i reklamave të faturuara kundrejt reklamave që duken në botime
 - Vendosja e numrave serikë të njëpasnjëshëm për reklamat dhe kontrollimi i vazhdimësisë numerike nga ana e atyre që përpilojnë faturat
- (iv) **Normat e tarifave të faturuara**
- Lista e autorizuar me çmime
 - Lista e autorizuar me zbritje
 - Krahasimi i buxhetit të vetë Grupit Atlantik nga reklamat me të ardhurat aktuale (për të identifikuar reklamat e botuara dhe të pa - faturuara)
 - Monitorimi i normës së fitimit për secilën reklamë për secilin botim
 - Vendosja e një përqindjeje minimale të fitimit për secilën reklamë për secilin botim
- (vi) **Përvetësimet e parave të gatshme**
- Arkëtarët duhet të mbikëqyrin hapjen e postës
 - Personeli i recepsionit duhet të lëshojë fletë arkëtime të para - numëruara në mënyrë serike për paratë e gatshme të arkëtuara ndaj të gjithë personave që bëjnë pagesa në recepsion
 - Duhet të ketë dy njerëz që të ndjekin hapjen e postës
 - Duhet të përpilohet një listë me arkëtimet e parave të gatshme
- (viii) **Mos - qenia në dispozicion e sistemeve**
- Duhet të krijohen plane rezervë për kontingjenca për sa i takon përfitim të reklamave dhe përpunimit e botimit të tyre, bashkë me përpunimin e përpilimin e faturave, në rast se sistemi bie
 - Duhet të bëhen teste për të bërë të sigurt se planet e bëra në rast të katastrofave janë të suksesshëm dhe dihen prej të gjithëve
- (x) **Rreziku i hedhjes në gjyq për reklama të papërshtatshme**
- Trajnimi i personelit për sa i takon Kodit Kosovar të Standardeve të Reklamimit për të reduktuar botimin e reklamave të papërshtatshme
 - Politikat e redaksisë mbi reklamat e botuara duhet t'i bëhen të ditura të gjithë personelit
 - Sistemi i raportimit duhet të përfshijë një zyrtar të emëruar përgjegjës për të gjitha pyetjet në lidhje me reklamat

Detyra 2

(a) 'Rregullimi' mund të përkufizohet si të gjitha format e ndërhyrjes së shtetit në mënyrën se si operon tregu i lirë. Një gjë e tillë përfshin rregullimin e kërkesës, ofertës, çmimeve, fitimeve, sasive, cilësisë, hyrjes në treg, daljes prej tij, informacioneve, teknologjisë, ose të gjitha aspekteve të tjera të prodhimit dhe konsumit që përmban tregu.

Megjithëse autoritetet janë përgjegjëse për të bërë të sigurt praninë e shumë - palëve që përbëjnë ofertën në një treg, sa herë që kjo të jetë e mundur, shpesh industria është një monopol natyror.

Kërkohet:

Shpjegoni dy metodat kryesore që përdoren për të rregulluar industrinë monopol. **(10 pikë)**

(b) Vlerësimi i performancës së Kryetarit të bordit të drejtorëve të kompanisë dhe Kryeshefit Ekzekutiv duhet të bëhet veçmas nga ajo e drejtorëve joekzekutivë, por të gjithë drejtorët duhet të kenë një lloj vlerësimi individual.

Kërkohet:

Cilat janë elementet që mund të përfshihen si kritere gjatë vlerësimit të performancës së kryetarit të bordit. **(10 pikë)**

(c) Menaxheri i rrezikut ka një rol të rëndësishëm në menaxhimin e rrezikut në organizatë.

Kërkohet:

Përshkruani rolet e menaxherit të rrezikut. **(5 pikë)**

(Totali = 25 pikë)

Zgjidhja

a)

(i) **Kontrolli i çmimeve**

Rregullatori bie dakord me industrinë për sa i takon faktit se sa do të jetë çmimi i prodhimit [outputit]. Në mënyrë tipike çmimi reduktohet përherë e më tepër vit pas viti duke dakorduar rritje çmimi të cilat janë më të vogla se sa norma e inflacionit. Një gjë e tillë është përdorur me sukses nga rregullatorët në Mbretërinë e Bashkuar megjithëse shpesh krijon probleme dhe konfrontime.

(ii) **Kontrolli i fitimeve**

Rregullatori bie dakord me industrinë për sa i takon faktit se sa do të jetë fitimi maksimal që mund të realizojë industria në fjalë. Një metodë tipike është fiksimi i fitimit maksimal si x% e kapitalit të përdorur. Megjithatë një gjë e tillë nuk shërben si një nxitje për të përdorur më me efikasitet pasuritë: sa më i lartë të jetë kapitali i përdorur aq më i lartë do të jetë fitimi.

b)

- **Qenia i pavarur** – mendimi i lirë, shmang konfliktet e interes
- **Qenia i përgatitur** – njeh mirë personelin kyç, organizatën dhe industrinë, është në dijeni të detyrave ligjore dhe të ngarkuara nga aksionarët
- **Qenia praktik** – merr pjesë aktive, ngre pyetje, insiston për të marrë informacione, ndërmerr arsimim profesional të mëtejshëm
- **Puna e komiteteve** – kupton proceset e punës së komiteteve, shfaq ide dhe entuziazëm
- **Zhvillimi i organizatës** – bën sugjerime për sa i takon novacioneve, drejtimeve strategjike dhe planifikimit, siguron mbështetje nga palët e jashtme të lidhura

c) **Rolet e menaxherit të rrezikut**

- Të ofroj leadership të përgjithshëm, vizion dhe udhëheqje, përfshirë vendosjen e politikave të menaxhimit të rrezikut, vendosjen e sistemeve të menaxhimit të rrezikut. Kërkimi i mundësive për përmirësimin dhe forcimin e sistemeve.
- Zhvillimi dhe promovimi i kompetencave, sistemeve, kulturës, procedurave, protokoleve të menaxhimit të rrezikut. Sistemet duhet të jenë të afta të vlerësojnë në mënyrë të saktë rrezikun me të cilin ballafaqohet kompania..
- Raportimi ndaj menaxhmentit dhe komitetit të rrezikut. Informatat duhet të jenë në formë të përdorshme nga menaxhmenti për të raportuar ndaj shfrytëzuesve të jashtëm pastaj.
- Sigurimi i pajtueshmërisë me kode, rregulloret dhe ligjet relevante.

Detyra 3

Ju është kërkuar të kryeni një auditim mjedisor në mënyrë që të vlerësoni se sa 'e gjelbër' është organizata juaj për sa i takon konsumit të energjisë, përdorimit të burimeve të rinovueshme dhe ndërgjegjësimin të punonjësve për sa i takon këtyre çështjeve.

Kërkohe:

(a) Përshkruani informacionet që do të dëshironit të kishit në dispozicion gjatë planifikimit të auditimit. **(9 pikë)**

(b) Shpjegoni mënyrën se si do të testonit ndërgjegjësimin e punonjësve dhe mënyrën se si do t'i kishit përfshirë të gjithë këta punonjës në këtë iniciativë. **(6 pikë)**

(c) Diskutoni arsyet se pse kompanitë dëshirojnë të japin shënime shpjeguese për informacionet mjedisore në pasqyrat e tyre financiare. Diskutoni faktin nëse është më mirë që vetë kompania të jetë ajo që vendos se cila do të jetë përmbajtja e këtyre shënimeve shpjeguese. **(10 pikë)**

(Totali = 25 pikë)

Zgjidhja

a)

Procesi i planifikimit

Procesi i planifikimit për të gjitha aktivitetet e hetimit sillet rreth të njëjtit bosht, që është shqyrtimi i **informacioneve që duhet të përftohen, i vendeve nga mund të përftohen informacionet në fjalë dhe i mënyrës se si do të përftohen ato.**

Informacionet në dispozicion

Në rastin e një auditimi për ambientin, shumica e informacioneve me mundësi të madhe janë tashmë në dispozicion në formën e regjistrave kontabël; **kostot e ngrohjes dhe ndriçimit**, për shembull mund të lidhen me faktorë të tillë si numri i punonjësve, sipërfaqja e punës dhe vëllimi i ndërtesave.

Në këtë rast ka disa **aspekte të praktikave të mira, të cilat janë pak a shumë standarde** për sa i takon ruajtjes së energjisë, të tilla si prania e izolimit të mureve dhe çatisë dhe kontrollet termostatike dhe kontrolli me sahat i sistemeve të ngrohjes së hapësirës dhe nxehjes së ujit. Ekzistenca dhe ruajtja e faktorëve të tillë mund të gjykohej nga regjistrat e duhur. Në Mbretërinë e Bashkuar, shërbimet komunale që ofrojnë energji, në të njëjtën kohë ofrojnë edhe këshilla për sa i takon ruajtjes së energjisë dhe kjo është diçka tjetër që duhet të merret në konsideratë.

Përdorimi i burimeve të rinovueshme duhet të jenë një çështje e politikave të kompanisë dhe departamenti i blerjeve duhet të jetë i aftë të japë komente për sa i takon shkallës së përmbushjes së diçkaje të tillë.

Këshillat e ekspertëve

Disa aspekte të tjera të konsumit të energjisë kërkojnë këshilla nga ekspertët. Për shembull, **qarqet me ajër të kompresuar** që përdoren në shumë fabrika për të vënë në punë veglat manuale dhe makineritë, mund të jenë shpenzuese shumë të mëdha të energjisë elektrike në rast se kanë të çara, meqenëse diçka e tillë bën që kompresori të duhet të punojë më gjatë se sa duhet për të ruajtur presionin e duhur. Megjithatë, matja e efikasitetit aktual të një sistemi pneumatik është një detyrë e specializuar inxhinierike.

Në rast se organizata është një organizatë prodhuese, do të ishte diçka e duhur marrja në konsideratë e shkallës ose e masës deri kur vetë **produktet** kanë qenë efikase për sa i takon përdorimit të **energjisë** dhe se deri në ç' masë janë përdorur burimet e rinovueshme edhe gjatë

përdorimit edhe gjatë ndërtimit të tyre. Këto janë kryesisht çështje të dizajnit dhe do të jetë i nevojshëm përfitimi i këshillave teknike.

Korniza e auditimit

Familja e standardeve ISO, të tilla si ISO 14000 dhe standardet e tjerat, ofrojnë një kornizë të përgjithshme që auditori me mundësi të madhe do të dëshironte ta mbante parasys, ndërsa në të njëjtën kohë përmbajnë edhe një deklaram specifik mbi auditimin e brendshëm.

(b)

Testimi i faktit se sa të ndërgjegjësuar janë punonjësit

Fakti se sa shumë janë në dijeni të çështjeve të tilla punonjësit, mund të matet nëpërmjet **vëzhgimit, plotësimit të pyetësorëve dhe intervistimit**. Në një organizatë të madhe mund të ndiqet qasja e mostrimit. Vëzhgimi duhet të jetë kryesisht modest dhe i rezervuar dhe ndërsa me mundësi të madhe do të ofrojë një kontroll të dobishëm mbi rezultatet e intervistave, meqenëse shumica e personelit mund të ketë ekzagjeruar shkallën ose masën e qenies së tyre në dijeni për çështjet e ambientit.

Përfshirja e punonjësve

Mund të përdoren teknikat e **marketingut të brendshëm** për të përfshirë në të punonjësit. Marketingu i brendshëm është përdorimi i teknikave të marketingut të cilat normalisht kanë të bëjnë me komunikimet që dalin nga organizata, për qëllime të brendshme. Ky është një koncept që ka të bëjë me menaxhimin e ndryshimeve dhe në këtë mënyrë mund të jetë diçka e përshtatshme për t'u përdorur edhe në këtë rast.

Në të njëjtën mënyrë mund të krijohet një fushatë e përbashkët. Ajo mund të përfshijë mesazhet e lëna në fletë kuitancat e pagave, në postera, në prezantime, **me anë të formimit të grupeve për diskutim**, dhe me anë të krijimit të një **skeme me sugjerime** e cila synon specifikisht çështjet e mjedisit. Në rast se ekzistojnë skema të tilla të fuqizimit, të tilla si qarqet e cilësisë, mund të jetë e mundur që skemave në fjalë t'u shtohet edhe një dimension i ri, ai i ambientit.

(c)

Interesat e palëve të interesuara

Interesi i publikut në përgjegjësinë sociale të korporatave është duke u rritur përherë e më tepër. Megjithëse qëllimi kryesor i pasqyrave financiare është paraqitja e informacioneve për investuesit dhe këshilltarët e tyre, përherë e më tepër njerëzit vihen në dijeni të faktit se kompanitë aktualisht, përveç aksionarëve, kanë **edhe shumë palë të ndryshme të interesuara**. Këto përfshijnë **klientët, punonjësit dhe publikun e gjerë**, dhe të gjitha këto palë me mundësi të madhe janë **të interesuar** në mënyrën me anë të të cilës veprimtaritë një e kompanie kanë ndikim mbi mjedisin natyror dhe komunitetin e gjerë. Këto palë të interesuara mund të kenë një **ndikim të konsiderueshëm mbi performancën e një kompanie**. Si rezultat shumica e kompanive, tani qëllimisht kërkojnë të ndërtojnë një **reputacion të mirë për sa i takon përgjegjësi sociale dhe ambientaliste**. Në këtë mënyrë, dhënia e shpjegimeve për sa i takon informacioneve ambientaliste dhe sociale është diçka thelbësore.

Interesat rregullative dhe profesionale

Një faktor tjetër është **interesi përherë në rritje i qeverive dhe i organizmave profesionale**. Megjithëse nuk ka **Standarde të Raportimit Financiar** të cilat kërkojnë në mënyrë specifike raportimin mbi çështjet e mjedisit dhe ato sociale, diçka e tillë mund të kërkohej nga **legjislacioni për kompanitë**. Tani ofrohen disa **shpërblime për raportet mbi mjedisin dhe ato sociale**, në rast se për çështjet në fjalë jepen shpjegimet e duhura në pasqyra financiare. Këto ofrojnë nxitje shtesë për sa i takon shpjegimit të informacioneve.

Ndikimi i performancës

Në të njëjtën kohë, përherë e më tepër besohet se **përgjegjësia sociale e korporatave është aktualisht një pjesë e rëndësishme e performancës së përgjithshme të një entiteti**. Praktikën e përgjegjshme në fusha të tilla si reduktimi i dëmeve të shkaktuara ndaj mjedisit dhe rekrutimi, **rrisin në fakt vlerat e aksionarëve**. Kompanitë të cilat veprojnë në mënyrë të përgjegjshme dhe që japin shpjegime për aktivitetet e tyre sociale dhe të mjedisit në përgjithësi **perceptohen si investime më të mira** në krahasim me korporatat që nuk e bëjnë diçka të tillë.

Shpallaosja e detyruar ose vullnetare e shpjegimeve

Tani për tani kompanitë normalisht kanë mundësinë të japin aq pak ose aq shumë **informacione sa dëshirojnë vetë, dhe normalisht në mënyrën që dëshirojnë**. Diçka e tillë shkakton disa **probleme**. Kompanitë kanë tendencën të japin shpjegime për informacione të **zgjedhura** dhe është e vështirë që përdoruesit e pasqyrave financiare të mund të **krahasojnë performancën e kompanive të ndryshme**. Megjithatë, ka edhe **argumente të mira** për sa i takon vazhdimin e lejimit të kompanive që të gëzojnë një masë të caktuar të lirisë, gjatë kohës që zgjedhin e përcaktojnë informacionet për të cilat japin shpjegime. Në rast se do të vendosen rregulla të hollësishme, **kompanitë me mundësi të madhe do të fillojnë të adoptojnë qasjen e 'listave kontrolluese'** dhe do të fillojnë t'i paraqesin informacionet në një mënyrë shumë të **përgjithshme dhe të standardizuar**, gjë e cila nuk është edhe aq e përdorshme dhe e dobishme për palët e interesuara.

Detyra 4

KUP ShA prodhon një gamë të produkteve kompjuterike duke përfshirë qipa kompjuterik të siliciumit, hard disqe dhe kartat e avancuara grafike nga fabrika e saj e vetme e vendosur në një qytet të mesëm në SHBA qendrore. Rreth 20% e popullsisë që punojnë janë të punësuar në KUP, dhe kompania ka një reputacion për të qenë një punëdhënës i mirë me fokus të veçantë në ruajtjen dhe rritjen e përfitimeve për punonjësit e saj. Një universitet lokal ka programe me lëndë në mënyrë specifike për punonjësit e mundshëm të KUP.

Edhe pse kompania është profitabile, pasqyrat e fundit të menaxhimit të tregojnë marzha në rënie me mundësinë e një humbje në vitin e ardhshëm, i pari në historinë 25 vjeçare të kompanisë. Arsyet kryesore për rënie të fitimeve janë identifikuar si rritja e konkurrencës nga prodhuesit në Lindjen e Largët, dhe çështjet e vazhdueshme të kontrollit të cilësisë me disa prodhues kryesorë. Një studim i fundit i fizibilitetit tregon se duke lëvizur prodhimin në një vend të Lindjes së Largët do të mundësojë KUP të përfitojnë nga kostot e punës më të ulët dhe të afërsisë me furnizuesit e komponentëve të kualitetit të lartë. Funksionet e administratës dhe të marketingut do të mbeten në vendndodhjen e tyre aktuale. Ndërsa një vendim përfundimtar ka ende për t'u bërë, Bordi është i vetëdijshëm për ndikimin negativ që mund të ketë kjo në imazhin e kompanisë dhe prandaj janë të gatshëm për të bërë një angazhim të fortë.

Lëvizja e sistemeve të prodhimit në Lindjen e Largët është parë si një problem të veçantë për KUP. Fushat specifike të shqetësimit përfshijnë:

- (i) Marrja dhe mbajtja e furnizimeve nga furnizuesit e ri
 - (ii) Ngritja e linjave të prodhimit me fuqi punëtore të re dhe makineri të reja
 - (iii) Mirëmbajtja e stokeve të mjaftueshme të materialeve për të plotësuar nevojat, kur kohët e dërgesës të janë të pasigurta
 - (iv) Zbatimi i çdo ndryshimi të nevojshëm në sistemet e kontabilitetit të menaxhimit
- Megjithatë, Bordi është i bindur se ky veprim do të jetë i suksesshëm dhe është duke pritur një përgjigje pozitive nga punëtorët dhe aksionarët.

Kërkohet

(a) Shpjegoni parimet kryesore të qeverisjes së shoqërive aksionere për kompanitë e listuara, me referencë të veçantë për krijimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi të kontrollit të brendshëm dhe rolin e auditimit të brendshëm.

(8 pikë)

(b) Identifikoni dhe vlerësoni çdo rrezik apo problem të mundshëm me sistemin e kontrollit të brendshëm në KUP që dalin nga vendimi për të transferuar operacionet në Lindjen e Largët, shkurtimisht përshkruani metodat për të minimizuar këto rreziqe ose probleme. **(17 pikë)**

(Total = 25 pikë)

Zgjidhja

(a) Qëllimi i qeverisjes së korporatave

Qeverisja e korporatave ka të bëjë me mënyrën në të cilën kompanitë qeverisen me qëllim të përgjithshëm të zbatimit të praktikave dhe të procedurave për të siguruar që një kompani është e drejtuar në përputhje me objektivat e saj. Parimi mbizotërues i qeverisjes lidhet me ndarjen midis pronësisë dhe kontrollit të një kompanie. Aksionarët e zotërojnë një kompani me blerjen e aksioneve dhe si rezultat i këtij rreziku të investimit, ata ndajnë përfitimet e pronësisë, pra dividendët e marrë. Megjithatë, drejtorët janë përgjegjës për të drejtuar kompaninë në baza ditore. Pasi që drejtorët janë agjentët e aksionarëve, ata duhet të sigurojnë se kompania është e drejtuar në dobi të aksionarëve; qeverisja e korporatave ofron funksion të kontrollit dhe raportimit për të treguar se interesat e aksionerëve janë duke u përmbushur.

Mund të ketë interesa të tjera që bordi i drejtorëve duhet gjithashtu të marrë parasysh në drejtimin e kompanisë të tilla si të punësuarit.

Sistemi i kontrollit të brendshëm

Pjesë e detyrës së tyre të përgjithshme për drejtorët është ngritja e një sistemi të kontrollit të brendshëm për të siguruar që transaksionet janë të regjistruara dhe pasuritë e kompanisë janë të mbrojtura. Elementet kryesore të një sistemi të kontrollit të brendshëm janë përmbledhur në Britani të Madhe nga ana e raportit Turnbull, vendet e tjera kanë udhëzime të ngjashme.

Sistemi i kontrollit të brendshëm duhet të:

(1) Lehtëson funksionimin efikas dhe efektiv të një kompanie, duke bërë të mundur që ajo të përgjigjet ndaj rreziqeve të veçanta që mund të pengojë atë nga arritja e objektivave të kompanisë. Rreziqet mund të jenë operative, financiare ose të pajtueshmërisë, për shembull, me objektivat që kanë të bëjnë me zovgëlimin e humbjeve të pasurive ose të siguruarit që detyrimet janë kuptuar dhe menaxhuar.

(2) Sigurimi i cilësisë (menaxhimin) së raportimit të brendshëm dhe të jashtëm.

(3) Sigurimi i përputhjes me ligjet dhe rregulloret dhe gjithashtu me politikat e brendshme të kompanisë në lidhje me udhëheqjen e përgjithshme të biznesit.

Megjithatë, ndërsa një sistem i shëndoshë i kontrollit të brendshëm nuk do të ofrojë siguri të plotë se situata e mësipërme nuk do të ndodhë, kjo ndihmojnë për të siguruar që mundësia e shfaqjes së tyre është minimizuar.

Auditimi i brendshëm

Një nga karakteristikat kryesore të një sistemi të kontrollit të brendshëm është krijimi dhe mirëmbajtja e një departamenti të auditimit të brendshëm, në fakt kjo është normalisht një kërkesë nga bursat për kompanitë e listuara të mëdha. Në auditim i brendshëm përcaktohet normalisht si 'një aktivitet vlerësim i pavarur i themeluar brenda një organizate, si një shërbim për të. Është një kontroll i cili funksionon, duke e shqyrtuar dhe vlerësuar përshtatshmërinë dhe të efektivitetin e kontroleve të tjera'. Departamenti i auditimit të brendshëm për këtë arsye i ndihmon anëtarët e tjerë të organizatës në kryerjen e përgjegjësive të tyre, nga bordi tek menaxherët junior në rishikimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Auditimi i brendshëm, pra, do të shqyrtojë sistemin e kontrollit të brendshëm mbi menaxhimin dhe sistemet e financiare të kontabilitetit për të identifikuar dobësitë potenciale dhe aktuale.

(b) problemet e mundshme me sistemet e kontrollit të brendshëm në KUP

Mungesa e veprimit të përshtatshëm

Duket se bordi i KUP kanë vënë në dukje problemin e mbajtjes së kapaciteteve prodhuese në SHBA dhe të paktën një veprim të mundshëm të lëvizjes së kapaciteteve në një vend të Lindjes së Largët. Për më tepër, nuk është e qartë nëse bordi vlerëson seriozitetin e situatës, ose ka opsione të tjera, të tilla si zvogëlimi i kostos së prodhimit në SHBA. Çfarë është e qartë është se nevojiten disa veprime për të siguruar që kompania të mbetet në ekzistencë. Dështimin për të marrë veprim mund të rezultojë në dështimin e bordit për t'i kryer detyrat e tyre për aksionerët duke shkaktuar humbjen e investimeve të tyre dhe të ardhmen e rrjedhës së të ardhurave.

Mungesa e mundshme e përvojës së përshtatshme të menaxhmentit

Mungesa e veprimit të bordit çon në një tjetër dobësi të kontrollit të brendshëm siç është mungesa e talentit të përshtatshëm menaxherial dhe kontrollit në nivel të bordit. Sistemi i kontrollit të brendshëm duhet të sigurojë cilësinë e përgjithshme të menaxhimit. Mungesa e vendimit për zhvendosjen në Lindjen e Largët mund të shkaktohet thjesht nga mungesa e aftësisë menaxhuese ose do të marrë atë vendim të vështirë.

Jo-pajtueshmërisë me ligjet e SHBA

Reduktimi i mundshëm në fuqinë punëtore në Shtetet e Bashkuara do të thotë se shumë punonjës do të kenë të drejtë për kompenzim. Ekziston mundësia e shkeljes së ligjit të punës, qoftë e qëllimshme apo jo, i përpunimit dhe pagesës së rrogave. Auditimi i brendshëm do të duhet të rishikojë çdo llogaritje të kompenzimeve për largim nga puna në bazë testimesh për të siguruar pajtueshmëri me ligjin e punës

Jo-pajtueshmërisë me ligjet e Lindjes e Largët

Krijimi i një fabrikë në Lindjen e Largët do të thotë se KUP do të duhet të jetë në përputhje me ligjet dhe rregullat e një vendi të huaj. Drejtorët duhet të sigurojnë që ligji në vend është kuptuar, ndoshta me punësimin e avokatëve vendor. Përndryshe, ekziston rreziku që KUP do të shkelë një ligj pa dashje e cila do të çojë në publicitet të dobët dhe, në ekstreme, mbylljen e fabrikës së re.

Rreziqet e përgjithshme të sistemeve të reja

Vendosja e një fabrikë të re në Lindjen e Largët do të thotë krijimin e menaxhmentit të ri dhe sistemeve të kontabilitetit financiar në atë vend. Sistemet e reja gjithmonë ka rrezik të dështojnë ose mund të ketë raportim të pasaktë për shkak të mungesës së testimi adekuat ose problemeve në implementim..

Rrezikjet e komunikimit -Lindja e Largët në SHBA

Krijimi i një vendi të ri të prodhimit do të thotë se kërkohet një komunikim i vazhdueshëm përmes raporteve të menaxhmentit në mes të dy vendndodhjeve. Ky system i ri i komunikimit do të ndikojë në rreziqe të tilla si ndërprerja e komunikimit ose informatat mund të pengohen gjatë transmetimit. Marrja me qira e kohës në një rrjet virtual privat do të ndihmojë për të ulur rrezikun e komunikimit.

Kontrolli i bordit

Distanca gjeografike nga SHBA në Lindjen e Largët mund të kufizojë aftësinë e bordit është për të ruajtur kontrollin e përshtatshëm të lokacionit të ri të prodhimit. Rreziku është se fabrika e re mund të prodhojë komponentët e saktë të kompjuterit, përballja me kufizimet e saj në lidhje me përzierjen e komponenteve të prodhuara ose raportin në mes të shitjeve dhe prodhimit. Për të ruajtur kontrollin adekuat, një drejtor mund të caktohet të jetë me vendbanim në lokacionin e ri.